



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E PODUJEVË / OPŠTINA PODUJEVO / MUNICIPALITY OF PODUJEVA DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK		
Dokument me Dostavljeno 10.01.2024		
Nr. orig. / Orig. Jed.	Nr. / Br.	Shtojcë - Prilog
15-300/01-003013/24 PODUJEVË - PODUJEVO		



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës Opština Podujevo Municipality of Podujeva  
**DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK**

Bazuar në nenin 62.3 të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, nenin 64 par.3 dhe 4 të statutit të Komunës nr.01-020/01-50862/18, nenin 18.3 të rregullores për kushtet/kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve nr.prot: 01-016/01-0030667/22 dhe bazuar ne planin e punës dhe ne buxhetin për vitin 2024, Drejtoria për Planifikim dhe Zhvillim Ekonomik shpall:

**FTESË PUBLIKE**  
*për aplikim në projektin:*  
**NGRITJA DHE ZHVILLIMI I BIZNESEVE**  
*(Mbështetje me 100 pajisje pune)*



*Makina qepëse e drejtë kompjuterike  
20copë*



*Makina qepëse Overlluk  
20copë*



*Kompresor 500L, kw 5.5  
15copë*



*Sharrë, shpejtësia e tehut të sharrës 19/38min, diametri  
i tehut të sharrës 315mm, këndi mitër -45 - +45°  
15copë*





*Ngritës me kriket për vetura 4000kg – lift  
**7copë***



*Makinë për ballancim të gomave  
**8copë***



*Aparat saldimi CO2, rryma e saldimit: 30 - 250A,  
diametri i telit të saldimit: Ø 0.6 - 1.2mm  
**15copë***



### **Të drejtë aplikimi kanë:**

- Banorë të Komunës së Podujevës – Biznese ekzistuese dhe Start up.

### **Kushtet për aplikim:**

- Biznesi veprimtarinë ta ushtrojë në territorin e Komunës së Podujevës.
- Të mos ketë obligime financiare të papaguara ndaj Komunës dhe ATK-së.

### **1) BIZNESET EKZISTUESE**

#### **Dokumentet e nevojshme për të aplikuar janë:**

- 1) Forma e aplikimit - aplikacioni
- 2) Kopjen e letërnjoftimit të aplikuesit (*në emër të cilit është i regjistruar biznesi*)
- 3) Deklaratë/Çertifikatë e bashkësisë familjare
- 4) Certifikatën e biznesit me informatat e biznesit (*jo më e vjetër se 3 muaj*)
- 5) Vërtetimin e tatimit në pronë (*dëshmi për pagesën e tatimit*)
- 6) Vërtetimin tatimor nga ATK (*dëshmi për pagesën e obligimeve*)
- 7) Deklaratën për bashkëfinancim 30%

#### **Forma e vlerësimit:**

Kriteret	Poena
1 Forma e aplikimit - Projekt propozimi;	<b>0-20</b>
2 Vizita në teren;	<b>0-30</b>
3 Dëshmi për përvojë në veprimtarinë aplikuese (Certifikatë/Vërtetim);	<b>10</b>
4 Biznes në pronësi të Gruas	<b>10</b>
5 Aplikues/e (biznese) që nuk kanë përfituar më parë nga ndonjë projekt, thirrje apo ftesë publike të Komunës në vitet (2022,2023 dhe 2024).	<b>30</b>

### **2) START UP**

#### **Dokumentet e nevojshme për të aplikuar janë:**

- 1) Forma e aplikimit - aplikacioni
- 2) Kopjen e letërnjoftimit të aplikuesit
- 3) Deklaratë/Çertifikatë e bashkësisë familjare
- 4) Vërtetimin e Tatimit në pronë (*dëshmi për pagesën e tatimit*)
- 5) Deklaratën për bashkëfinancim 30%





### **Forma e vlerësimit:**

Kriteret	Poena
1 Forma e aplikimit - Projekt propozimi	<b>0-20</b>
2 Vizita në teren;	<b>0-30</b>
3 Dëshmi për përvojë në veprimtarinë aplikuese (Certifikatë/Vërtetim);	<b>10</b>
4 Aplikuese Grua	<b>10</b>
5 Aplikues/e (familje) që nuk kanë përfituar më parë nga ndonjë projekt, thirrje apo ftesë publike të Komunës në vitet (2022,2023 dhe 2024).	<b>30</b>

Aplikimi fillon me datë 10.01.2024 dhe mbaron 30.01.2024, Dokumentet për aplikim mund mirren pranë Drejtorisë për Planifikim dhe Zhvillim Ekonomik dhe ato duhet të dorëzohen në zyrën e shërbimit të qytetarëve në Komunën e Podujevës.

### **VËREJTJE:**

- Një aplikant nuk mund të dorëzoj më shumë se një aplikacion në këtë thirrje publike, por në një aplikim mund të bëjë kërkesë për dy pajisje nga pakoja e përgjithshme e ofruar e pajisjeve.
- Për Start-Up aplikimi duhet të bëhet nga personat të cilët synojnë të fillojnë biznesin, jo nga persona të tjerë në emër të tyre dhe pas shpalljes si përfitues duhet regjistruar biznesin.
- Për Biznese ekzistuese aplikimi duhet të bëhet nga pronarët/aksionarët e bizneseve siç figurojnë në çertifikatën e ARBK-së apo të autorizuarit e tyre.
- Përfituesit do të marrin pjesë (participim) me 30% të vlerës së projektit.
- Personi fizik apo juridik vetëm një herë në vit mund të jetë përfitues i subvencioneve të ndara nga komuna. *(neni 6.2 i rregullores së subvencioneve)*
- Në bazë të numrit të përgjithshëm të aplikacioneve të pranuara, komisioni gëzon të drejtën të vendos për të subvencionuar bizneset me një apo dy pajisje nga pakoja e përgjithshme e ofruar.
- Në aplikacionet e pranuara evidentohen (aplikues, pronar i biznesit apo familjar të tyre që kanë qenë përfitues në vitet 2022,2023 dhe 2024 nga ndonjë projekt, thirrje apo ftesë publike e Komunës), komisioni varësisht nga numri i përgjithshëm i aplikacioneve të pranuara, gëzon të drejtën të vendos lidhur me shqyrtimin apo mos shqyrtimin e aplikacioneve dhe realizimin e vizitave të tyre në teren.
- Aplikacionet me dokumentacion të pakompletuar dhe të dorëzuara pas afateve kohore nuk do të merren parasysh.

Drejtor i DPZHE:

*Z. Vigan Salihu*